

NATO NE MEDIAT SHQIPTARE

Monitorim dhe analizë e mbulimit dhe e trajtimit të temës së Aleancës Atlantike në shtypin shqiptar

Me mbështetjen e Ambasades se Norvegjise ne Tirane

QËLLIMI

Integrimi i Shqipërisë në Aleancën Atlantike, duke qenë një nga orientimet themelore të programeve të të gjitha qeverive shqiptare të periudhës postkomuniste, përfaqëson një nga fushat kryesore të interesit publik në vend. Në reflektim të kësaj prirjeje, çështja e Aleancës Atlantike paraqitet si një nga tematikat e rëndësishme të medias shqiptare për raportet e Shqipërisë me NATO-n, por edhe për njohjen dhe përgatitjen e opinionit publik me tendencat, misionet, përshtatjet dhe kapacitetet e Aleancës Atlantike përballë sfidave të reja të shekullit 21.

Monitorimi dhe analiza e mbulimit dhe e trajtimit të temës së Aleancës Atlantike në shtypin e Shqipërisë bëhet në funksion të ndriçimit të shkallës, mënyrave dhe nivelit të përgjigjes, që mediat japin për interesin, pikëpyetjet, paqartësitë dhe vakumin informativ të opinionit publik, si dhe në funksion të ndihmës dhe të bashkëpunimit për përmbushjen e një detyre të karakterit profesional.

Periudha e monitorimit është zgjedhur nga muaji nëntor i vitit 2006 deri në muajin qershor të vitit 2007. Zgjedhja nuk është e rastësishme, por lidhet me dy ngjarje kulmore të interesit publik, mediatik e politik për raportet e Shqipërisë me NATO-n: 1-Samiti i kryetarëve të shteteve dhe të qeverive të vendeve anëtare të Aleancës Atlantike, mbajtur në Riga të Letonisë më 28-29 nëntor 2006, dhe 2- Vizita e presidentit të SHBA, Xhorxh Bush, në Tiranë më 10 qershor 2007. Të dyja këto ngjarje trajtohen dhe vlerësohen në media në dritën e sensibilitetit dhe interesit pothuajse mbarëpopullor për çështjen e integrimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Objekt i monitorimit dhe i analizës janë bërë pesë nga gazetat e përditëshme shqiptare dhe konkretisht, "Shekulli", "Gazeta Shqiptare", "Panorama", gazeta "Shqip" dhe "Tema". Këto gazeta sëbashku mbulojnë pjesën më të madhe të tirazhit dhe të hapësirës së opinionit publik në vend dhe analiza e pasqyrit nga ana e tyre të temës atlantike mendojmë se jep një hartë dhe pamje më të qartë të trajtimit të kësaj teme nga mediat shqiptare në përgjithësi.

Interesimi i mediave shqiptare për NATO-n dhe çështjet atlantike nuk ka vijimësi dhe as frekuencë të rregullt, por duket i kushtëzuar nga ngjarje dhe zhvillime, të cilat e pozojnë NATO-n me dy çështjet bazë të interesit mediatic shqiptar:

1- Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, dhe

2-Qendrimi i NATO-s ndaj çështjes së statusit dhe pavarësisë së Kosovës.

Jashtë këtij fokusi strategjik dhe jashtë ngjarjeve e zhvillimeve, të cilat lidhen me të, tema e NATO-s si organizatë bëhet objekt rralë herë ose vetëm me rastin e ndonjë vizite studimore të gazetarëve shqiptarë në selinë e NATO-s, si ajo që u organizua në muajin maj 2007 dhe ku pjesëmarrësit pasqyruan në gazetatat e tyre përshtypjet, takimet, informacionet dhe idetë, që morën nga ajo vizitë.

TRAJTESA PROFESIONALE

Në periudhën e analizuar tema atlantike në mediat përkatëse ka një dinamikë jo të njëtrajtëshme. Gazeta "Tema" i ka kushtuar kësaj teme 50 artikuj, korespondenca dhe lajme, pastaj vjen gazeta "Panorama" me 24 artikuj dhe lajme, "Gazeta Shqiptare" dhe gazeta "Shekulli" me nga 14 shkrime secila dhe gazeta "Shqip" me 13 artikuj dhe lajme.

Ngjarjet bazë të pasqyruara janë samiti i NATO-s në Riga dhe vizita e presidentit amerikan Bush në Tiranë, gjithmonë të trajtuara në dritën e çështjes së anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe më pak në atë të qendrimit ndaj çështjes së statusit të Kosovës. Përtej këtyre dy problemeve, ka ndonjë përpjekje për një spektër më të gjërë të çështjeve atlantike, si misioni në Afganistan apo gjetkë, apo roli i NATO-s në kushtet e reja të marrëdhënieve ndërkombëtare. Por kjo përpjekje në mediat është e vogël në krahasim me interesat e publikut për të njohur në vazhdimësi NATO-n dhe rolin e saj në sfidat e mijëvjeçarit të ri.

Të gjitha gazetatat, kur shkruajnë për NATO-n dhe sidomos për dy ngjarjet kulmore, që përmendëm më sipër, u japin atyre vendin kryesor në krye të faqeve dhe disa prej tyre përdorin një apo dy faqe speciale. Por hapësira nuk është e njëjtë.

Për samitin e Rigës gazeta "Panorama" dhe gazeta "Tema" kanë shkrime edhe për ditën e parë të tij, pra më 29 nëntor 2006, edhe për ditën e dytë të samitit, pra më 30 nëntor 2006, si dhe për vlerësimet e zyrtarëve të lartë të shtetit shqiptar për këtë samit më 1 dhjetor 2006, ku gazeta e parë jep vlerësimin nga ana e presidentit të Shqipërisë, kurse gazeta e dytë vlerësimin nga kryeministri i Shqipërisë. "Gazeta Shqiptare" ka dy shkrime, një pas ditës së parë dhe një pas ditës së dytë të samitit. Gazeta "Shqip" dhe gazeta "Shekulli" kanë vetëm nga një shkrim, e para më 30 nëntor dhe e dyta më 29 nëntor 2006 për ditën e parë të samitit dhe fjalën e presidentit Bush në të.

Në titujt e tyre gazetatat të gjitha veçojnë shpresën e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO si mesazhi kryesor politik, që ato i përcjellin publikut nga punimet e takimit të nivelit të lartë atlantik.

"Gazeta Shqiptare" një titull e ka: "Bush: Shqipëria ftesë me 2008" dhe tjetri shkrim: "NATO: Shqipëria ftesë me 2008". Gazeta "Shekulli": "Shqipëria, ftesë në NATO më 2008". "Panorama" një shkrim me titull: "Bush: Shqipëria të anëtarësohet në NATO"

dhe tjetri: "Riga, ftesë Shqipërisë për në NATO". Gazeta "Tema" një shkrim e ka me titull: "Nato:Ftesë në vitin 2008 për anëtarësim" dhe një shkrim me titull: "Presidenti Bush: Mbështetje anëtarësimi të Shqipërisë në NATO". Gazeta "Shqip" një shkrim me titull: "NATO fton Shqipërinë të anëtarësohet në vitin 2008".

Titujt tingëllojnë më optimistë se sa rezultatet reale të samitit dhe me sa duket kjo reflekton emocionin e dëshirës publike për ta parë Shqipërinë sa më shpejt anëtarë në NATO. Vetëm dy gazeta vendosin edhe nëntituj, që kujtojnë se ka ende rrugë për të bërë deri tek anëtarësimi. Gazeta "Shqip" vendos nëntitull "Por vendi ynë duhet të plotësojë detyrimet politike dhe ushtarake", dhe gazeta "Panorama" ka nëntitull: "Nëse kriteret plotësohen dyert e NATO-s janë të hapura më 2008".

Përsa i përket vizitës së presidentit të SHBA në Tiranë, integrimi atlantik i Shqipërisë paraqitet si një element dhe një theks kryesor i pasqyrimin të vizitës në shtyp. Në tre gazeta dominojnë titujt, që e shohin vizitën e Bushit në këtë optikë. Gazeta "Tema" ka boton dy shkrime, një me titull "Bush: SHBA do të mbështesin pa rezerva integrimin në NATO" dhe shkrimi tjetër me titull : "Berisha, Sanader dhe Gruevski: Kemi mbështetjen e SHBA për samitin e Bukureshtit". Gazeta "Shqip" boton një shkrim me titull: "Bush, Nuk janë plotësuar standartet për në NATO". Gazeta "Shekulli" shkrim me titull: "Ftesa për në NATO, vendet e A3 pas plotësimit të kriterëve". Gazeta "Panorama" dhe "Gazeta Shqiptare" nuk vendosin tituj, që e lidhin viziten e presidentit Bush në Tiranë me integrimin atlantik.

Burimet e përdorura nga gazetatat në trajtimin e çështjeve atlantike janë dy llojesh:

1-Të drejtpërdrejta, që lidhen me takime të drejtpërdrejta me përfaqësues të zyrave të NATO-s apo me politikanë dhe zyrtarë shqiptarë për çështje, që kanë të bëjnë me temën e NATO-s.

2-Të tërthorta, që përbëjnë burimin kryesor, dhe që lidhen me njoftimet e agjencive të lajmeve, me komunikata zyrtare të zyrave qeveritare e shtetërore brenda e jashtë vendit, me konferenca shtypi e intervista të udhëheqësve të ndryshëm të vendeve anetare të NATO-s,etj.

Për arsye të njohura dhe të kuptueshme gazetatat shqiptare nuk kanë korespondentë jashtë vendit apo konkretisht në Bruksel, ku ndodhet selia e NATO-s dhe që do të kishte ndihmuar kontaktin e drejtpërdrejt dhe sistematik të mediave shqiptare me burimet dhe veprimtaritë atlantike. Përgjatë bën gazeta "Tema", që rezulton me një korespondente në Bruksel, por edhe ajo kur shkruan për NATO-n përqëndrohet në deklaratën e samitit atlantik të zhvilluar në Riga.

Nuk konstatohet nga gazetatat një përpjekje e programuar për të mbuluar hendikepin e burimeve nëpërmjet botimit të artikujve dhe analizave nga mediat apo institucionet e vendeve anëtare të NATO-s lidhur me problematikën atlantike. Gjatë periudhës së monitoruar gazeta "Tema" ka botuar tre artikuj me autorë të huaj, nga të cilat dy lidhen me raportet e NATO-s me Shqipërinë dhe një për politikën franceze në Aleancën Atlantike. Gazeta "Shqip", "Shekulli" dhe "Panorama" kanë botuar nga një artikull me autorë të huaj, kurse "Gazeta Shqiptare" asnjë.

Gazetat përqëndrohen në dy ngjarjet kulmore të kronikës politike atlantike, por jo të gjitha i kushtojnë vëmendje përgatitjes së opinionit me ngjarjen në prag të saj dhe me konkluzionet apo vazhdimësinë tematike pas ngjarjes .

Në gazetën "Tema" në muajin qershor të vizitës së Bushit në Shqipëri për temën atlantike boton shkrime në dhjetë dite, nga të cilat në datën 11 qershor hasen po për këtë temë 6 materiale, ndërsa në datën 22 qershor dy materiale. Po nga kjo gazetë botohen në muajin maj materiale me temë atlantike në tetë ditë. Gazeta "Shqip" ka në muajin qershor shkrime me këtë temë në katër ditë të muajit dhe një shkrim në muajin maj. Gazeta "Panorama" ka materiale me temen atlantike në katër ditë në qershor dhe në dymbëshjetë ditë në muajin maj. Gazeta "Shekulli" ka shkrime në tre ditë në muajin qershor dhe në pesë ditë në muajin maj të vitit 2007. "Gazeta Shqiptare" nuk ka shkrim me këtë temë në muajin qershor dhe ka shkrime në tre ditë në muajin maj.

Nuk paraqitet gjithmonë proporcional interesi i mediave me atë të publikut lidhur me NATO-n. Përgjithësisht gazetat kanë përcjellë shqetësimin dhe emocionin e opinionit dhe institucioneve për çeshtjen e integritetit të Shqipërisë në NATO. Por këtë e kanë bërë duke u paraqitur ata si zëdhënës të këtij interesi publik, ndërsa nuk gjen në asnjërin prej tyre përpjekje për ta sjellë direkt zërin, mendimin dhe interesin e opinionit publikut shqiptar për zhvillimet në NATO dhe për integritetin atlantik të Shqipërisë. Nuk gjen intervista, anketime, citime, opinione të drejtpërdrejta të publikut, të shtresave apo grupeve të ndryshme shoqërore se si i shohin ata problemet që lidhen me procesin e integritetit të Shqipërisë në NATO apo me vetë NATO-n si organizatë.

Edhe sondazhet, që janë organizuar për NATO-n në opinionin publik shqiptar nga institucione apo shoqata joqeveritare, nuk gjejnë pasqyrim të njëjtë në shtyp. Gazeta "Tema" dhe "Panorama" i japin hapësirë sondazhit përkatës të organizuar nga "Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve" për NATO-n. Gazeta "Shqip" jep sondazhin e organizuar nga "Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim". Gazeta "Shekulli" dhe "Gazeta Shqiptare" nuk pasqyrojnë asnjë sondazh.

Gazetat nuk duket se i kanë kushtuar njëllë kujdesin e nevojshëm krijimit të gazetarëve të specializuar për çeshtjet e NATO-s dhe të sigurisë. Në periudhën e monitoruar, gazeta "Tema" ka botuar 6 artikuj me emër, nga të cilët 5 janë të një autori dhe një shkrim i një autori tjetër. Gazeta "Shqip" ka katër artikuj me emër, nga të cilët 2 të një autori dhe dy të tjerët nga dy autorë të tjerë. Gazeta "Panorama" ka 8 artikuj me emër, nga të cilët 3 të një autori, dy autorë të tjerë me nga dy artikuj dhe një artikull me autor tjetër. "Gazeta Shqiptare" ka 6 artikuj, nga të cilët tre autorë kanë secili nga dy artikuj. Gazeta "Shekulli" ka 4 artikuj me emër, nga të cilët një autor dy dhe dy autorë të tjerë nga një artikull.

Në shkrimet me autorë ka shume citime apo referenca në deklaratime nga fjalime apo konferenca shtypi të personaliteteve të ndryshme të vendeve të NATO-s dhe keto shpesh here zenë pjesën më të madhe të shkrimit, duke dominuar mbi analizën apo interpretimin e zbërthimit të faktit, ngjarjes apo qëndrimit. Kjo krijon përshtypjen për disa shkrime, që ngjajnë më shumë me lajme të komentuar.

Shkrimet më të plota dhe më konkrete në ide dhe informacion, dhe që sjellin edhe diçka të re për lexuesin janë ato të autorëve, të cilët kanë marrë pjesë në vizitën studimore të një grupi gazetarësh shqiptarë në selinë e NATO-s, gjë që evidenton

vlerën e kontaktit të drejtpërdrejtë të shtypit shqiptar me NATO-n , me mekanizmat dhe funksionimin e saj.

Është pozitive që artikujt, korespondencat dhe lajmet lidhur me NATO-n shoqërohen me foto të ndryshme, gjë që tërheq më shumë vëmendjen e lexuesit për informacionin e paraqitur. Duhet thënë se fotot, që përmbajnë e japin vetë informacion për veprimtari të NATO-s janë tepër të rralla. Bie ne sy një varfëri tematike e fotove dhe një përsëritje e tyre nga një gazetë në tjetrën ose edhe brenda së njëjtës gazetë.

Gazeta "Shekulli" ka gjithsej 13 foto shoqëruese të shkrimeve me temën atllantike. Nga këto, 4 herë është botuar fotografia e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jap de Hop Shefer, 3 herë e presidentit të SHBA-së, Xhorxh Bush, dhe tre herë e kryeministrit të Shqipërisë. "Gazeta Shqiptare" ka botuar 16 foto shoqëruese. Nga këto, 2 herë foto të Sheferit, 4 herë të Berishës, dhe 1 e Bushit. Gazeta "Panorama" ka botuar 24 foto shoqëruese. Nga këto, një herë foto e Bushit, 3 herë të Sheferit, 2 herë të Berishës, etj. Gazeta "Shqip" ka 16 foto shoqëruese. Nga këto, 4 herë foto të Bushit, 3 herë të Sheferit. Gazeta "Tema" ka 21 foto shoqëruese. Nga këto, 5 herë foto të Bushit, 3 herë të Sheferit, 4 herë të Berishës.

Në gjithë gazetat gjen të botuar foto nga selia e NATO-s apo simbolin e NATO-s. Fotot përgjithësisht janë të ngjashme nga gazeta në gazetë, gjë që vjen siç duket nga burimi i njëjtë furnizues, agjencitë e huaja. Mungojnë foto origjinale të fotoreportereve shqiptarë.

Intervistat lidhur me temën atllantike janë të rralla. Gazeta "Panorama" boton një intervistë me kryetarin e komisionit të sigurisë kombtare të Kuvendit të Shqipërisë, Leonard Demi. Gazeta "Tema" boton një intervistë të ministrit të mbrojtjes, Fatmir Mediu, dhënë BBC-së, një intervistë me kryeministrin Berisha dhe një me këshilltarin e kryeministrit shqiptar për çështjet e sigurisë, Tom Rixh, intervista të cilat nuk janë posaçërisht për NATO-n, por kanë nga një pyetje për integrimin atllantik të Shqipërisë. "Gazeta Shqiptare" boton një intervistë të ministrit të mbrojtjes, F. Mediu, dhënë BBC-së. Dy gazetat e tjera nuk kanë intervista me këtë temë.

Në gazetat mungon debati për temat atllantike dhe pasojat apo implikimet e integritimit atllantik në politikën, shoqërinë shqiptare, sigurinë apo forcat tona të armatosura. Vetëm gazeta "Tema" boton një shkrim për fjalën e kryetarit të Komisionit të Sigurisë në Kuvend, Leonard Demi, lidhur me efektet e krijimit të një grupi koordinues për integrimin në NATO dhe të një koordinatori kombtar për këtë proces, por vetë gazeta nuk shpreh opinion për këtë ngjarje. Njoftimin e mësipërm apo ndonjë diskutim për këtë çështje nuk e gjejmë në gazetat e tjera. Një shkrim gjejmë të botuar në gazetën "Panorama" lidhur me standartet e ushtrisë shqiptare në drejtim të pajisjeve të rekrutëve.

Përgjithësisht gazetat i kushtojnë në faqet e tyre rëndësi dhe vend të dukshëm shkrimeve, njoftimeve apo fotove me temë atllantike. Por kjo nuk është e njëjtë në të gjithë gazetat. Në gazetën "Tema" shkrimet, korespondencat apo lajmet për veprimtari atllantike dhe NATO-n vendosen 21 herë në krye të faqes, dhe 8 herë i gjejmë të vendosura në pjesë të tjera të faqes. Në gazetën "Shqip" i gjejmë 5 herë të vendosura në krye të faqes dhe 7 herë në pjesët e tjera të faqes. Kjo gazetë, të nesërmen e mbylljes së samitit të Nato-s në Riga, e vendos shkrimin për këtë samit poshtë lajmit

për vizitën e ministrit të jashtëm të Shqipërisë në Kinë, lajm i cili vendoset në krye. Edhe më 19 nëntor kjo gazetë njoftimin për rezolutën e senatit amerikan në mbështetje të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO e vendos poshtë njoftimit se SHBA do të sjellin në Shqipëri 3 të burgosur nga Guantanamo.

Gazeta "Panorama" i vendos shkrimet me temë atlantike 6 herë në krye të faqes dhe 13 herë në pjesë të tjera të faqes. Edhe kjo gazetë, një ditë pas mbylljes së samitit të NATO-s në Riga, e vendos njoftimin e samitit poshtë lajmit për vizitën e ministrit të jashtëm shqiptar në Kinë, i cili vendoset në krye të faqes.

"Gazeta Shqiptare" i vendos shkrimet 4 herë në krye të faqes dhe 4 herë në pjesë të tjera të saj. Edhe kjo gazetë, një ditë pas mbylljes së samitit të NATO-s, vendos në krye të faqes lajmin për vizitën e ministrit të jashtëm shqiptar në Kinë dhe poshtë tij shkrimin për samitin atlantik. Gazeta "Shekulli" i vendos shkrimet atlantike 6 herë në krye të faqes dhe 5 herë në pjesë të tjera të faqes.

Nuk haset asnjë shkrim apo korespondencë apo lajm me temë atlantike në faqe të parë të ndonjë gazete, me përjashtim të gazetës "Panorama", e cila një herë hap në faqen e parë një artikull të presidentit të Francës, Zhak Shirak, kushtuar samitit të NATO-s në Riga.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Aleancën Atlantike është tema dominuese e artikujve, korespondencave dhe lajmeve në gazetatat e monitoruara. Të gjitha bashkohen në qendrimin se Shqipëria duhet të hyjë në NATO dhe se ka të drejtë për këtë. I përbashkët është edhe këndvështrimi, sipas të cilit SHBA janë vendimtarët në hapjen e derës së anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Në këtë prizëm shihet kryesisht edhe vizita e presidentit të SHBA, Xhorxh Bush, në Tiranë.

Ndonëse në gazetatat gjen referenca nga palë të treta për kriteret, standartet dhe kushtet, që duhet të plotësojë një vend aspirant për anëtarësim në NATO, lexuesi nuk gjen konkretisht se çfarë janë këto kriteret e standarte, çfarë reformash dhe veprimesh duhet të ndërmerret Shqipëria në aspektin ushtarak dhe politik, etj. I vetmi kusht, që del konkretisht nëpër faqet e shtypit, është kërkesa që buxheti ushtarak i vendit të arrijë 2 përqind të prodhimit të përgjithshëm kombëtar, gjë që është parashikuar të arrihet në vitin 2008.

"Gazeta Shqiptare" ka gjithsej 5 tituj, në të cilat theksi vihet tek kriteret, që duhen plotësuar para se të arrihet anëtarësimi atlantik. Gazeta "Shekulli" ka 4 tituj me theksin tek kriteret. Gazeta "Shqip" dhe gazeta "Panorama" kanë nga tre tituj, gazeta "Tema" ka 2 tituj me theksin tek kriteret. Nuk gjen në gazetatat shkrime dhe analiza për detyrat, vështirësitë, përgjegjësitë dhe angazhimet konkrete, që i dalin Shqipërisë në një anëtarësim të mundshëm atlantik dhe çfarë barre politike, ushtarake e morale, të brendshme dhe ndërkombëtare, sjell anëtarësimi për shtetet anëtarë të rij të NATO-s.

I gjen pak të pasqyruar në shtyp në mënyrë autentike, të drejtpërdrejtë dhe të plotë, dokumente apo komunikata të NATO-s dhe të forumeve e veprimtarive të rëndësishme atlantike. Gazetat preferojnë t'i japin komunikatat apo deklaratat në ligjëratë të zhdrejtë nëpërmjet dorës së gazetarëve të tyre. Deklaratën e samitit të NATO-s në Riga, pjesën për zgjerimin e aleancës dhe që paraqet interes të drejtpërdrejtë për opinionin publik shqiptar, e boton tekstualisht vetëm gazeta "Tema",

e cila zgjedh ta bëjë këtë dy ditë me rradhë. Po kjo gazete boton edhe pjesën e deklaratës së samitit të NATO-s në Riga lidhur me Kosovën. Gazeta "Panorama" boton tekstualisht nga deklarata vetëm dy fjali për zgjerimin. Gazetat "Shekulli", gazeta "Shqip" dhe "Gazeta Shqiptare" nuk botojnë pjesë apo citime të plota të deklaratës së samitit.

Edhe tema e qendrimeve dhe raporteve të NATO-s me çështjen e Kosovës nuk duket se gjen pasqyrimin, që mendohet se duhet të kishte kjo tematikë dhe sidomos për periudhën e monitoruar, e cila është nga më të fokusuarat në vëmendjen ndërkombëtare për statusin e Kosovës. "Gazeta Shqiptare" dhe gazeta "Shqip" kanë nga një shkrim lidhur me qendrimin e NATO-s ndaj çështjes së statusit të Kosovës. Gazeta "Shekulli" ka 2 shkrime, gazeta "Panorama" ka 4 shkrime dhe gazeta "Tema" 5 shkrime. Shkrimet janë thjeshtë njoftime apo korespondenca për deklarata apo komunikata dhe nuk ka artikuj të mirfilltë të gazetave për këtë temë.

DISA KONSIDERATA TË PËRGJITHËSHME

Shtypi shqiptar ka arritur përgjithësisht të përcjellë shqetësimin, emocionin dhe interesin e opinionit publik, të shoqërisë civile dhe të institucioneve shtetërore për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe rëndësinë e NATO-s për Shqipërinë. Shtypi qëndron në përputhje me rrymën e përgjithëshme popullore dhe shtetërore të orientimit atlantik dhe anëtarësimit në Aleancë. Nuk ka disonancë në mendimin dhe qendrimin e përgjithshëm pozitiv të opinionit dhe të institucioneve ndaj rolit dhe misionit të NATO-s.

Shtypi shqiptar, pavarësisht orientimeve dhe prirjeve editoriale të njëjës apo tjetrës gazetë, është i njëzëshëm në bindjen se Shqipëria duhet të jetë anëtare e NATO-s.

Ka një vijë të qartë mediatike të mbështetjes për integrimin atlantik të Shqipërisë dhe për rolin dhe vendin e NATO-s në botën e sotme. Ndonjë nuancë, që vërehet në lidhje me procesin apo ritmet e anëtarësimit të Shqipërisë, ka të bëjë me një pozicion kritik të gazetës përkatëse ndaj politikës së qeverisë, por ky pozicion nuk shkon në vënien në dyshim të së drejtës dhe meritës së Shqipërisë për të qenë anëtare e NATO-s.

Nga hapësira dhe intensiteti i trajtimit të tematikës atlantike në mediat e Shqipërisë rezulton se opinionin publik ka nevojë të njihet më shumë me problemet konkrete të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, me detyrat konkrete që kanë institucionet, qeveria dhe shoqëria shqiptare në procesin e integritit atlantik, të njihet me vetë karakterin dhe profilin e organizatës së NATO-s në ditët e sotme, me reformat dhe transformimin e saj të vazhdueshëm politiko-organizativo-strategjik, me filozofinë e saj të re në kushtet e sfidave dhe problemeve të mprehta ndërkombëtare, që Aleanca nuk i ka patur gjatë 50 vjetëve të parë të jetës së saj, siç është lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar, misionet luftarake jashtë perimetrit të saj gjeografik, etj.

Tematika atlantike nuk zë hapësirën, që do të duhej të zinte për opinionin publik të një vendi, i cili kërkon dhe po lufton të anëtarësohet në NATO dhe ku një nga orientimet dhe objektivat kryesore strategjike është integrimi në Aleancën Atlantike. Konstatohet një nevojë e një ndërgjegjësimi më të madh profesional për rëndësinë dhe vazhdimësinë mediatike të çështjes së pasqyrimin të temës atlantike në mediat shqiptare.

Mungojne analizat dhe zberthimet e detyrave, kritereve dhe pergjegjësive të Shqipërisë në procesin e integritimit në aleancën atlantike. Në këtë drejtim nuk gjen pasqyrim në shkrime ndjekja e procesit të reformave në ushtri dhe e zbatimit të standarteve dhe normave atlantike në forcat tona të armatosura, cilat janë vështirësitë, pengesat, çfarë nënkupton dhe përfaqëson konkretisht performanca e Shqipërisë në një garë anëtarësimi, e cila është individuale dhe jo në bazë grupi. Ka vetëm një shkrim në gazetën "Panorama" lidhur me papërshtatshmërinë e pajisjeve të rekrutëve të rij në një repart ushtarak. Po kështu nuk pasqyrohen reformat politike e demokratike, që kërkon NATO, por kalohen ato thjeshtë me një term apo rresht, në një kohë që publikut do të ishte më i interesuar se çfarë kërkon NATO nga Shqipëria në këto fusha.

E krahasuar me pasqyrimin në mediat shqiptarë të problematikës së integritimit në Bashkimin Europian, çështja e integritimit atlantik rezulton me një hapësirë dhe një vëmendje mediatike më të vogël si dhe me një presion më të ulët dhe nxitje më të vogël të shtypit mbi institucionet shtetërore përse i përket procesit të reformave të nevojshme për integritimin atlantik.

Nuk hasen shkrime e njoftime për probleme të brendëshme të Aleancës Atlantike, të detyrave dhe roleve të saj në një botë në ndryshim, të marrëdhënieve mes vendeve anëtare, të përshtatjes apo të përplasjes së vizioneve, që shtete anëtare kanë për rolin dhe reformat brenda Aleancës Atlantike. Fokusimi tek anëtarësimi si tematikë qendrore mediatike ka lënë anash dhënien e informacionit dhe situatës për zhvillimet dhe reformat brenda për brenda kësaj aleance, ku Shqipëria synon të jetë anëtare.

Kjo bëhet e nevojshme duke mbajtur në konsideratë se mediat kanë përballë një publik, i cili është heterogjen dhe përbëhet nga gjenerata të reja të kohës së demokracisë, të cilat kanë nevojë të mësojnë çfarë është NATO e shekullit 21 dhe përse Shqipëria duhet të jetë anëtare, si dhe nga gjenerata të vjetra, të cilat në kohën e komunizmit kanë qenë të detyruara të ushqehen me informacione të deformuara mbi NATO-n dhe kanë nevojë më shumë për informacion të përditësuar.

Në shtyp nuk gjen informacion mbi qëndrimet e shteteve të veçanta anëtare të NATO-s për zgjerimin në përgjithësi dhe për anëtarësimin e Shqipërisë në veçanti. Dihet se debati europian lidhur me zgjerimin ka kaluar në një formë apo tjetër edhe në NATO, ku shtete të Bashkimit Europian, të cilat nuk janë në favor të zgjerimit të BE-së me anëtarë të rij, kanë ngritur objeksione edhe lidhur me zgjerimet e mundshme në NATO. Shtypi ende nuk po e përgatit opinionin për këto zhvillime e tendenca të reja brenda NATO-s, të cilat mund të sjellin afate, detyra apo kritere shtesë në rrugën e integritimit atlantik.

REKOMANDIME

Për shtypin shqiptar:

-T'i kushtojnë hapësirë dhe frekuencë më të madhe problemeve të NATO-s dhe sidomos të kenë vijimësi dhe aktualizim të problematikës atlantike.

- Të krijojnë brenda redaksive gazetarë të specializuar apo të mbajnë afër ekspertë të jashtëm të rregullt, të çeshtjeve atlantike dhe të sigurisë.
- Të organizohen debate ekspertësh, intelektualësh dhe zyrtarësh mbi efektet pozitive dhe kërkesat e situatat e reja, që sjell anëtarësimi atlantik për vendin tonë.

Për NATO-n:

- Të organizojë rregullisht vizita studimore të përfaqësuesve të mediave shqiptare në selinë e NATO-s, por edhe pjesë marrje të tyre në veprimtari të ndryshme atlantike.
- Të ndihmoje mediat shqiptare me libra, broshura, informacione, video, etj. që kanë të bëjnë me problematikën dhe zhvillimet në Aleancën Atlantike.
- Të sponsorizojë veprimtari mediatike apo të institucioneve mediatike në Shqipëri për popullarizimin e Aleancës.
- Zyra Përfaqësuese e NATO-s në Tiranë të organizojë konferenca të rregullta shtypi me mediat shqiptare për veprimtaritë atlantike.

Për institucionet shqiptare:

- Mediat të konsiderohen faktor bashkëpunues dhe ndihmues në realizimin e procesit të reformave të kërkuara për integrimin atlantik.
- Tu japin mediave informacione të rregullta për procesin e reformave në forcat e armatosura dhe në fusha të tjera, të kërkuara nga NATO, dhe t'i krijojnë akses të rregullt mediave në veprimtaritë dhe programet shtetërore të integritit atlantik.
- Të krijojnë mundësi të pjesëmarrjes së grupeve të gazetarëve në veprimtari të rëndësishme politike e ushtarake të NATO-s, brenda e jashtë vendit, ku janë të ftuar drejtues dhe institucione të shtetit shqiptar.

Tiranë, shtator 2007